

BESARD ZELI – ADZM DURRËS

Drejtor i Administratës së Zonave të Mbrojtura Durrës (ADZM Durrës).

Z. Besard Zeli mban pozicionin e Drejtorit të Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura Durrës.

Është diplomuar në Universitetin Bujqësor të Tiranës, në Fakultetin e Inxhinierisë Pyjore, ku ka përfunduar studimet Bachelor në Inxhinieri Pyjore, si dhe ka përfunduar studimet Master në Menaxhim Mjedisi në Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit.

Karrierën profesionale e ka nisur në vitin 2016 pranë Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura Durrës, fillimisht në pozicionin e specialistit të menaxhimit, ku është angazhuar në menaxhimin e zonave të mbrojtura, zbatimin e planeve të menaxhimit, monitorimin e biodiversitetit dhe rehabilitimin e habitateve dhe ekosistemeve të degraduara.

Prej vitit 2020 deri në shtator 2024 ka mbajtur pozicionin e Përgjegjës të Sektorit të Monitorimit, duke koordinuar punën për monitorimin dhe kontrollin në zonat e mbrojtura, zbatimin e legjislacionit dhe masave për parandalimin e dëmtimeve të natyrës, pyjeve dhe biodiversitetit, si dhe kontrollin e veprimtarive të paligjshme.

Prej shtatorit 2024 mban pozicionin e Drejtorit të Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura Durrës.

Gjatë karrierës së tij profesionale ka fituar eksperiencë në menaxhimin e zonave të mbrojtura, monitorimin e biodiversitetit, zbatimin e planeve të menaxhimit dhe drejtimin e strukturave administrative.

Z. Zeli zotëron gjuhën italiane dhe angleze në nivel të avancuar, si dhe gjuhën gjermane në nivel të mirë.